



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr. 14 Prot.

Vlorë, më 11 . 09 . 2018

**VENDIM**

Nr. 12 \_ Data 29.08.2018 \_

**Për shtyrjen e vendimit në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të ujit të rrjedhës së përroit të Gurës dhe Bënçës, Degë e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Hydrotec 2" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrër, subjektit "Hydro Tec" sh.p.k., me administrator Z. Elton Mataj .**

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, **Nr. 526, datë 21.10.2016 "Vënie në dijeni"**,

**VENDOSI**

Për shtyrjen e vendimit në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të ujit të rrjedhës së përroit të Gurës dhe Bënçës, Degë e lumit Vjosë, për ndërtimin e hidrocentralit "Hydrotec 2" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Tepelenë, Qarku Gjirokastrër, subjektit "Hydro Tec" sh.p.k., me administrator Z. Elton Mataj me këto të dhëna :

Koordinatat: Vepra e marrjes 1 X 44 09 940; Y 44 58 060; Z 306  
Vepra e marrjes 2 X 44 09 860 Y 44 58 315 Z 306



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"**

Prurja mesatare v1 : 4.290 m3/sek  
Prurja mesatare v2 : 0.720 m3/sek

Prurja e llogaritur v1: 4.600 m3/sek  
Prurja e llogaritur v2: 0.800 m3/sek

Prurja e ekologjike v1: 0.400 m3/sek  
Prurja e ekologjike v2: 0.070 m3/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë **1960 kW**

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"**

**Ilir PROFKA**

**KRYETAR I K.B.U "VJOSË"**

**Flamur MAMAJ**